



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 17, datë 22.01.2020

PËR

MASAT NDAJ SHOQËRISË SË SIGURIMIT
“SIGMA INTERALBANIAN VIG” SH.A.

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 2) dhe pika 21), si dhe nenit 32, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, nenit 149, pika 1), të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Bazuar në nenin 152, pika 1, germa b) dhe 153, pika 1, germa i) të Ligjit nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, urdhërohet Këshilli Mbikëqyrës i shoqërisë të shkarkojë funksionarin kryesor në departamentin e dëmeve të shoqërisë “VIG Service” sh.p.k., për shkelje të nenit 12, të Ligjit nr. 10076, datë 12.02.2009.
2. Bazuar në pikën 2, të nenit 246, të Ligjit 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, sanksionohet me gjobë personi përgjegjës i shoqërisë në masën 300,000 lekë, për shkelje të pikës 1, të nenit 215, të këtij ligji.
3. Shoqëria e sigurimit të ndërpresë të gjitha marrëveshjet e ndërmjetësimit me bankat e nivelit të dytë dhe agjenci udhëtimi të palicencuar nga Autoriteti, deri në plotësimin e kuadrit ligjor dhe rregullator për ushtrimin e këtij aktiviteti konform ligjit.
4. Bazuar në nenin 152, pika 1), germa a), të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, Autoriteti urdhëron shoqërinë e sigurimit “Sigma Inter Albanian VIG” sh.a. dhe Këshillin Mbikëqyrës të shoqërisë, të eliminojë shkeljet dhe parregullsitë e konstatuara si më poshtë, që lidhen me:

- 4.1 Zbatimin e dispozitave të nenit 225, të Ligjit 52/2014 “Detyrat e Aktuarit të autorizuar”;
- 4.2 Provigjonimin në përputhje me Rregulloren nr. 9, datë 25.01.2016 “Mbi bazat dhe metodat e llogaritjes, mënyrat e mbajtjes së provigjoneve teknike, si dhe kriteret dhe procedurat e miratimit të tyre nga Autoriteti”;
- 4.3 Raportimin në mënyrë të plotë të dhënat në lidhje me risqet dhe praktikat e dëmeve në bazën e të dhënave të dëmeve në Autoritetit, sipas kërkesave të Aneksit II, Tabelat I dhe II të Rregullores nr. 9, datë 25.01.2016, e ndryshuar;
- 4.4 Investimin e fondit të garancisë sipas kërkesave të pikës 7, të nenit 81, të Ligjit 52/2014 dhe Rregullores nr. 86, datë 03.07.2017 “Mbi administrimin e fondit të garancisë së shoqërisë së sigurimit dhe rastet e ndërhyrjes”.
5. Bazuar në nenin 154, pika 1, të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014, shoqëria të eliminojë shkeljet dhe parregullsitë e dala nga inspektimi si dhe të paraqesë një raport të detajuar brenda datës 10.02.2020.
6. Ngarkohen Departamentet përkatëse për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Ervin METE

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV
Ervin KOÇI